



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr. 69 , datë 1.10.2018

PËR

**“SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SUBJEKTIT REGJISTRUES TË
DOMAINEVE NËN .AL “SHQIPËRIACOM SH.P.K” PËR ANULLIMIN E VENDIMIT
TË KËSHILLIT DREJTUES NR.41, DATË 04.06.2018”**

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare e Këshillit Drejtues Znj. Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 01.10.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7 datë 16.02.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- **“Shqyrtimin e ankimit administrativ të subjektit Regjistruar të domaineve nën .al “ShqipëriaCom sh.p.k” për anullimin e vendimit të Këshillit Drejtues nr.41, datë 04.06.2018”**

BAZA LIGJORE:

1. Gërma k) e nenit 8 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “ Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji 9918/2008**);

2. Nenet 128 e vijues i Ligjit nr. 44/2015, “Kodit i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (*ligji44/2015*);
3. Rregullore Nr. 02 datë 21.02.2008 për “Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”, e ndryshuar;
4. Vendimi Nr. 67 dt 01.10.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar”.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Ankim Administrativ i datës 30.07.2018 (nr.2049 Prot, datë 30.07.2018, i AKEP) i Regjistruerit të domaineve nën .al “ShqipëriaCom sh.p.k.”;
2. Projekt Vendimi shqyrtimin e ankimit administrativ të subjektit regjistruer të domaineve nën .al “ShqipëriaCom sh.p.k” për anulimin e Vendimit të Këshillit Drejtues nr.41, datë 04.06.2018;
3. Relacionin shoqërues të projektvendimit,

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

I. NË ASPEKTIN PROCEDURAL:

1. AKEP, pasi mori në shqyrtim ankimin administrativ të Regjistruerit të domaineve nën .al “ShqipëriaCom sh.p.k.”, ndaj Vendimit të KD-së Nr.41, datë 04.06.2018, “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr.2, datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”” e ndryshuar, konstaton se, ankimi është paraqitur brenda afateve ligjore dhe plotëson kushtet e pranimit sipas nenit 132 dhe 135 të Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

II. NË ASPEKTIN E TRAJTIMIT NË THELB TË ÇËSHTJES:

2. Regjistruesi “ShqipëriaCom sh.p.k.” me shkresën nr.2049 Prot, datë 30.07.2018, i AKEP, ka paraqitur pranë AKEP ankimin administrativ kundër Vendimit nr.41, datë 04.06.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr.2, datë 21.02.2008, “Për regjistrimin e domaineve nën.al, dhe nëndomainet .gov.al, mil.al, edu.al, com.al, org.al dhe .net.al””;

3. Regjistruesi shpjegon se pasi është njohur me Vendimin nr.41, datë 04.06.2018, të Këshillit Drejtues të AKEP, legjitimohet plotësisht për të paraqitur këtë ankim duke parashtruar dhe pretendimet mbi aktin administrativ në fjalë si më poshtë:

i. Me Vendimin nr.41, datë 04.06.2018 të Këshillit Drejtues, AKEP i ka dhënë vetes cilësinë e “Regjistruetit”, përcaktim ky i cili shkel parimet e konkurrencës dhe tejkalon kompetencat ligjore të AKEP. Sipas regjistruetit “ShqipëriaCom sh.p.k.”, AKEP nuk mund të jetë njëkohësisht edhe në rolin e rregullatorit duke përcaktuar rregullat e regjistrimit dhe administrimit të domaineve .al, si dhe në rolin e regjistruetit, i cili duhet të zbatojë këto rregulla.

ii. Me anë të Vendimit nr.41, datë 04.06.2018, AKEP ka vendosur kufizimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike si pasojë e përcaktimit të kufizimit të numrit të domaineve deri në 5 për individ, dhe 15 domaine për subjekte juridik. Vendosja e këtij kufizimi në numrin e domaineve, sipas regjistruetit në fjalë cënon parimin e lirisë ekonomike dhe vjen në kundërshtim me politikat e liberalizimit të tregut. Sipas tyre, kufizimi i të drejtave të parashikuara në nivel Kushtetues mund të bëhen vetëm me ligj, në mënyrë proporcionale dhe jo me akte nënligjore si Rregullore. Sipas subjektit “ShqipëriaCom sh.p.k ”, qëllimi i AKEP nuk është rregullimi i tregut apo i ndonjë zhbancimi apo keqfunksionimi por ridimensionimi ose i shprehur ndryshe “zhvleftësimi” i portofolit të regjistrave ose poseduesve me më shumë se 5 apo 15 domaine. Pozita rregullatore e AKEP por njëkohësisht dhe ajo e regjistruetit dhe e regjistrit (të trajtuara me lart)—bëjnë që ky kufizim të jetë një hap i parë dhe vendimtar drejt monopolizimit të tregut të domaineve nga AKEP dhe kontrollit të një hapësire tregtare ekonomike vetëm nga Shteti Shqiptar.

iii. Regjistruesi “ShqipëriaCom sh.p.k.”, shprehet në vazhdim se terminologjia e sugjeruar në ndryshimet e bëra në Rregulloren nr.2, datë 21.02.2008, krijon probleme dhe dëm për Regjistrarët aktualë. “ShqipëriaCom sh.p.k.” e sheh të domosdoshme që AKEP të harmonizojë terminologjinë me atë të përdorur nga ICANN dhe WIPO. Në vijim, regjistruesi sugjeron që AKEP të përcaktojë termin “Akreditim” si në vazhdim: *“Akredituar ose Akreditim nënkupton identifikimin dhe përcaktimin e standardeve minimale për kryerjen e funksioneve të regjistrimit, njohjen e personave ose subjekteve që përmbushin ato standarde dhe lidhjen e një marrëveshjeje akreditimi që përcakton rregullat dhe procedurat e zbatueshme për sigurimin e Shërbimit të Regjistrimit të domaineve për palë të treta”*. Në Pikën 1.1, të Nenit 1, të Rregullores Nr. 2 të ndryshuar, të përcaktohet që: *“Regjistruetit” janë subjektet e akredituara nga Autoriteti Përgjegjës (AKEP) për të bërë regjistrimin e domaineve nën .al në përputhje me këtë Rregullore. Kushtet për veprimtarinë e Regjistruetit dhe Formulari i Aplikimit janë sipas përcaktimeve në Aneks nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 të Rregullores nr. 2, dt.21/02/2008*. Në Nenin 120, termi “regjistruetit”- *“janë subjekte të akredituara nga Regjistri për të bërë regjistrimin e domaineve nën .al në përputhje me këtë Rregullore. Kushtet për Regjistruetit dhe Formulari i Aplikimit janë sipas përcaktimeve në ANEKS nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 të Rregullores nr. 2, dt. 21/02/2008*.

iv. Regjistruesi “ShqipëriaCom sh.p.k.”, pretendon se lidhur me përditësimin e listës së termave të ndaluar dhe listës së emrave të rezervuar (në referim me ndryshimin

në pikën 19.2 të nenit 19, të Rregullores nr. 2, datë 21.02.2008), ICANN dhe Regjistarët e ndryshëm nëpër botë nuk ushtrojnë kufizim të paracaktuar, por krijojnë një periudhë *sunrise* ku ai që dëshiron të regjistrojë e regjistron domainin në emrin përkatës, e më tej përcaktohen kriteret se si zgjidhen konfliktet e mundshme për markat dhe patentat. Mbi të gjitha, problematikat e mbrojtjes ligjore të markave dhe patentave janë të trajtuara në sistemin juridik shqiptar si subjekte të ligjeve të posaçme dhe do të ishte e papranueshme që një ent rregullator të merrte përsipër gjykimin mbi përkatshmërinë e një marke.

v. Sipas regjistruesit “Shqipëriacom sh.p.k.”, në pikën 3 “Të drejtat dhe detyrimet e Regjistruesit” të Aneksit 1, të Rregullores Nr. 2, datë 21.02.2018, të AKEP përcaktohet në pikën g) revokimi i menjëhershëm i licencës në rast përsëritje. Sipas pretendimeve të regjistruesit ky paragraf është i papërcaktuar saktë, evaziv dhe subjekt interpretimi ku nuk është e qartë çfarë nënkuptohet me përsëritje. Paragrafi bie ndesh me Ligjin 9918/2008 ku përcaktohen dhe përshkallëzimet që merren në rast kundravajtjesh. Sipas nenit 132 e vijues të Ligjit 9918/2008 përcaktohet se për evidentimin e problemeve, ka një procedurë “Inspektimi”. Marrja e një mase revokimi të menjëhershme bie në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 9918/2008, pjesa për kundravajtjet administrative dhe gjobat si dhe me procedurat e regjistrimit të sipërmarrësve. Për këtë arsye, regjistruesi “Shqipëriacom sh.p.k.”, mendon që AKEP duhet të shtojë në rregullore edhe masat administrative që merren në rast se nuk përmbushen kërkesat e propozuara në këtë propozim dhe përcaktim i qartë i përshkallëzimit që çon në revokimin e akreditimit.

vi. Së fundi, regjistruesi “Shqipëriacom sh.p.k.” kërkon që Neni 4/1 Rregullores nr. 2, datë 21.02.2008, në formën që është miratuar të anulohet dhe në fund të nenit 4/1 të Rregullores nr. 2 aktuale të shtohet fjalia: “*AKEP siguron që sistemi i regjistrimit dhe Administrimit të domain-eve .al të mundësojë regjistrimin e menjëhershëm të domain-eve*”.

vii. Në përfundim të këtij ankimi, regjistruesi “ShqipëriaCom sh.p.k.”, në referim me Ligjin nr.44/2015, dt. 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", kërkon nga AKEP:

“Anullimin e Vendimit nr.41, datë 04.06.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP, dhe harmonizim të rregullores duke e përshtatur me kuadrin ligjor shqiptar si dhe me rregullat e ICANN dhe WIPO”.

III. KONSTATIMET DHE ARSYETIMI I AKEP.

4. Në përgjigje të ankimit administrativ që ka sjellë regjistruesi “Shqipëriacom sh.p.k.” AKEP thekson së pari se ndryshimet në këtë rregullore janë kryer sipas parashikimeve dhe në frymën e Ligjit 9918/2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, legjislacionin e BE-së në fushën për mbrojtjen e konsumatorit, si dhe bazuar në praktikën më të mira rregullatore që zbatohen nga shumë rregullatorë sot në vendet e BE-së dhe jashtë saj. Në vijim AKEP paraqet qëndrimin e tij të përmbledhur në pikat e mëposhtme:

- i. Lidhur me pretendimin se përcaktimi i AKEP si Regjistrar është i paligjshëm, se shkel parimet e konkurrencës dhe tejkalon kompetencat ligjore të autoritetit rregullator, shprehemi se në bazë të gërmës k) të nenit 8 të ligjit 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Për të përmbushur qëllimin dhe objektivat rregullatorë, të përcaktuara nga ky ligj, AKEP-i ka kompetencë të administrojë domain cc.TLD.al, nëndomanet e tij , si edhe ENUM”, AKEP ka tagrin ligjor të administrimit të domaineve .al, detyrim ky në të cilin përfshihet pa asnjë ekuivok dhe përgjegjësia në lidhje me regjistrimin direkt të tyre.

- ii. Lidhur me pretendimin e dytë të ngritur nga regjistruesi se vendosja e kufizimit në numrin e domaineve, në 5 për individ dhe 15 për shoqëri çënon parimin e lirisë ekonomike dhe vjen në kundërshtim me politikat e liberalizimit të tregut, theksojmë se numri i lejuar i *domaineve .al* sipas rregullit të ri të përcaktuar në pikën 7.1 b) të Rregullores, nuk përbën një numër kufizues (apo censurues) mbi të drejtën e përdorimit të këtyre domaineve, por një rregull procedural kushtëzues sasior për të orientuar përdorimin e tyre efektiv sipas qëllimit për të cilin janë marrë në posedim, brenda një afati 1(një) vjeçar. Nëse një posedues ka nevojë për një numër më të madh *domainsh .al*, apo nëndomainsesh të tij, se sa ai i përcaktuar në pikën 7/1 b) të Rregullores, duke arsyetuar nevojën, është i lejuar të pajiset nga AKEP me të drejtën e posedimit të tyre duke vendosur kushtin e përdorimit brenda afatit 1(një) vjeçar. Ky rregull është i sanksionuar në pikën 7/1 c) të Rregullores sipas së cilës: “Në rast se për nevoja teknike, tregtare, etj, por të arsyetuara, kërkohet të regjistrohen më shumë *domaine .al* se numri i përcaktuar në pikën b, regjistrimi i domaineve shtesë bëhet vetëm me miratimin e AKEP, por me kushtin që të vendosen në punë sipas afatit të mësipërm. Të interesuarit mund ti drejtojnë këtë lloj kërkese Regjistruesit të preferuar (ose AKEP nëse ka *domaine* të regjistruara nëpërmjet AKEP). Regjistruesi e përcjell elektronikisht këtë lloj kërkese në AKEP brenda 3 ditëve pune e cila shqyrtohet dhe i jepet përgjigje brenda afateve dhe përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative”. Vendosja e këtyre rregullave është bërë nga AKEP, pasi është analizuar sjellja e deri më tanishme e të gjitha kategorive të poseduesve të *domain.al*, nevojat e tyre historike statistikore, rastet abuzive dhe keqpërdorimi për arsye interesi në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, duke ia nënshtuar paraprakisht vendimmarrjen një procesi të gjatë konsultimi publik dhe dëgjësive me palët e interesuara. Në mbrojtje të interesave legjitime të çdo poseduesi të *domain.al* dhe nëndomaineve të tij, për të mos lejuar keqpërdorimin e mëtejshëm abuziv dhe antiligjor të përdorimit të tyre, u vendos kushti i përdorimit të një numri të caktuar *domainsh*, por jo të kufizuar, brenda afatit 1(një) vjeçar, si dhe u parashikua investimi i AKEP si organ i shqyrtimit administrativ të ankesave të mundshme nga subjektet e interesuara.
AKEP, në lidhje me këtë pretendim pranon në mënyrë të pjesshme kundërshtimin përkatës dhe me Vendimin Nr.67 datë 01.10.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar”, ka miratuar ndryshimin se, “Hyrja në fuqi e kufizimit të numrit të domanin-eve përcaktuar në nenin 7, pika 7.1 b) të Rregullores Nr. 2 të bëhet në mënyrë të shkallëzuar, 1 (një) vit nga data e hyrjes në fuqi të ndryshimeve në rregullore”. Ky kufizim synon kalimin e emrave të

domaineve tek përdoruesit e tyre. AKEP do të monitorojë përgjatë vitit këtë proces në mënyrë që të sigurohet që kjo periudhë tranzitore po përdoret sipas këtij qëllimi nga regjistrarët. Gjithashtu me Vendimin Nr.67 datë 01.10.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar”, AKEP, ka miratuar ndryshimin se, “Kjo masë e kufizimit të numrit të domain-eve do të veprojë për një periudhë 2 vjecare nga fillimi i aplikimit të saj”. AKEP, në bashkëpunim me regjistruesit do të çmojë nëse do të jetë e nevojshme mbajtja e kësaj mase në përfundim të kësaj periudhe”.

- iii. Sa i përket pretendimit të tretë që sugjeron se terminologjia e përdorur krijon probleme dhe dëm për Regjistraret aktualë, AKEP sqaron se, termi “Regjistrim” është termi më i përshtatshëm i cili përcaktohet edhe në pikën 4, gërma e), të Aneksit 1, të Rregullores nr. 2, datë 21.02.2008 ku procesi që kryen AKEP është regjistrim i Regjistruesve. Emërtimi “akreditim” është cilësuar në disa akte ligjore dhe Vendime të Këshillit të Ministrave, ku veçojmë Ligjin Nr.114/2016 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në RSH” dhe VKM nr.667, datë 29.7.2015, “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit”. Në ligjin Nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në RSH”, i ndryshuar, nuk përmendet termi “akreditim” dhe ndaj në këtë kuptim AKEP ka gjykuar se ky term nuk duhet të përdoret në Rregulloren nr.2, datë 21.02.2008, për të shmangur keqkuptime dhe hapsirat për interpretim që mund të lindnin me përcaktimet e ligjit 114/2016 pasi regjistrimi i domaineve nuk ka lidhje me aktivitete të vlerësimit të konformitetit. Bazuar në ligjin nr. 9918/2008, AKEP nuk gëzon të drejta për akreditimin e subjekteve. Termi “i akredituar” i përdorur nga ICANN, përdoret në kuptimin “i njohur”/i pranuar”. Ndryshimi është bërë në frymën e këtyre përcaktimeve.
- iv. Lidhur me pretendimin e katërt të subjektit, i cili kundërshton zgjerimin e listës së rezervuar me emrat e markave dhe patentave shprehemi se zgjerimi i përcaktimeve të nenit 19.2 i Rregullores nr.2, datë 21.02.2008, është bërë me qëllim eliminimin e abuzimeve dhe përdorimin e padrejtë të pronësisë industriale nga palë të treta. Ky ndryshim është bërë për të rritur garancinë e respektimit të të drejtave të zotërueseve të markave dhe patentave të regjistruara konform përcaktimeve të legjislacionit në fuqi që rregullon regjimin e pronësisë industriale. Në vijim të këtij pretendimi, AKEP pranon pjesërisht kundërshtimin dhe për rrjedhojë ka bërë ndryshimet me Vendimin Nr.67 datë 01.10.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al dhe nëndomainet .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar”, ku në pikën 19.2 të Rregullores është shtuar paragrafi në të cilën parashikohet se “Përjashtim bën rasti kur kërkuesi i një emri domaini nën “.al”, pasi është konsultuar me linkun e faqes ëb zyrtare me DPPI - seksioni i databazës online të markave/patentave/dizenjove industriale të regjistruara, së bashku me të dhënat e kërkuara të regjistrimit, deklaron me shkrim që ai pranon të lirojë atë domain brenda 30 ditëve nga marrja dijani, pa paraqitur asnjë ankim apo kërkesë për kompensim, nëse emri i të njëjtit domain do të kërkohej të posedohet nga poseduesi i markës/patentës/dizenjos industriale.

- v. Më tej lidhur me pretendimin e regjistruarit “Shqipëriacom sh.p.k.” se shkronja g), pika 3 “Të drejtat dhe detyrimet e Regjistruarit” të Aneksit 1, të Rregullores Nr 2, të ndryshuar, të AKEP, ku përcaktohet revokimi i menjëhershëm i licencës në rast përsëritje, është një paragraf i papërcaktuar saktë, evaziv dhe subjekt interpretimi ku nuk është e qartë çfarë nënkuptohet me përsëritje, AKEP sqaron se, pika 3, aneksi 1 i Rregullores Nr. 02, datë 21.02.2008, për “Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”, e ndryshuar; përcakton qartësisht cilat raste përkufizohen si shkelje. Në kuptim të gërmës u), të pikës 3, të aneksit 1 të Rregullores së sipërcituar termi “Përsëritje” nënkupton se, heqja eventuale e licencës nuk bëhet në mënyrë të menjëhershme por pasi e tillë është konstatuar si shkelje nga AKEP, dhe në mënyrë të përsëritur regjistruari dështon të marrë masat e duhura për të korrigjuar apo riparuar shkeljet e kryera. Kjo nënkupton se heqja e licencës do të kryhet vetëm pasi regjistri tregohet tërësisht pasiv ndaj procedurës së paralajmërimit të ndërmarrë nga AKEP.
- vi. Lidhur me pretendimin e fundit të subjektit “Shqipëriacom sh.p.k.” për regjistrimin dhe Administrimin e domain-eve .al nga AKEP në mënyrë të menjëhershme dhe jo sipas ndryshimeve brenda 3 ditë pune, sqarojmë se afati 3 ditor ka si qëllim t’i vijë në ndihmë subjekteve për të krijuar kushte sa më optimale dhe në ndihmë të aplikuesëve në rastet kur mund të ndodhë që ka gabime në aplikim dhe për të mos i hequr të drejtën aplikuesit për të marrë domainin e dëshiruar. AKEP ka gjykuar të arsyeshëm aftin 3 ditor për procesimin e aplikimeve në mënyrë që të shterojë të gjitha procedurat e nevojshme për finalizimin e procesit dhe dhënien e domainit.

PER KËTO ARSYE:

Bazuar në gërmën k), të nenit 8, dhe të pikës 1, të nenit 114 të Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe nenet 128 e në vijim të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të ankimit administrativ të regjistruarit “ShqipëriaCom sh.p.k.” .
2. Të njoftohet subjekti “Shqipëriacom sh.p.k.” për këtë Vendim.
3. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga data e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të internetit të AKEP.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

KRYETAR

Irir ZELA

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI

2. Edlira DVORANI

3. Ketrin TOPÇIU

4. Klarina ALLUSHI